



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:218926
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05488359

Ac.nr.5747/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Lumni Sallauka antarë të kolegjit, në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal në Prishtinë, me seli në Prishtinë, rr.”Ernes Koliqi” p.nr, kundër të paditurit, I.(E.) H. nga fshati Sh. – P., me objekt të kontestit, kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar paditësja, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 3168/18, të datës 01.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjensia Pyjore e Kosovës-Drejtoria Kordinuese Rajonale në Prishtinë, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.3168/18, i datës 01.06.2022, dhe çështja i kthehet në **ri vendosje**, gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar C.nr.3168/18 të datës 01.06.2022, ka vendosur si në vijim:

HEDHET poshtë padia e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal në Prishtinë, me seli në Prishtinë, rr.“Ernes Koliqi” p.nr, që në këtë gjykatë identifikohet me shenjën C.nr.3168/18 e datës 26.10.2018, e ushtruar kundër të paditurit, I. (E.) H.i nga fshati Sh. – Prishtinë, për kompensim të dëmit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

I padituri nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të ankesës së të paditurës së dytë, shqyrtimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 pika (d), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditëses Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal në Prishtinë, me seli në Prishtinë është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal në Prishtinë, me seli në Prishtinë, me datë 26.10.2018 ka ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurit I.(E.) H. nga fshati Sh. – P.. Me aktvendimin e datës 22.11.2021, paditëses i është kthyer padia në plotësim, me të cilin është ftuar, që brenda afatit prej tre ditësh ta plotësoj me adresë të saktë të paditurit ose t'i propozoj gjykatës që të njëjtit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm konform dispozitave të LPK-së, duke ia tërhequr vërejtën për pasojat ligjore të mos veprimit sipas tij. Paditësja, me datë 26.05.2022, ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën në të cilën ka dhënë adresën e njëjte të të paditurit, ashtu siç është e cekur në padi. Gjykata, vlerëson se në rastin konkret parashtrësja e datës 26.05.2022, është kthyer e pa korigjuar dhe e pa plotësuar, ngase nuk është vepruar sipas aktvendimit të datës 21.10.2021, andaj, konform nenit 102, paragrafi 3 lidhur me nenin 387, paragrafi 1, pika ë) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, tani për tani nuk e pranon si të drejtë dhe qëndrueshëm, edhe pse i njëjti aktvendim nuk është shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 të LPK-së dhe atë pika b), g), j), k) dhe m), për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, megjithatë, i njëjti aktvendim është i shoqëruar me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore që i referohen mos vërtetimit të drejtë dhe plotë të gjendjes faktike dhe atë nenit 182 par.1, lidhur me nenin 79 të Ligjit për Procedurë Kontestimore që kanë të bëjnë me autorizimin sipas detyrës zyrtare të gjykatës për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm me shpenzime të palës paditëse, dhe mbi këtë bazë, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret aktvendimi i atakuar me ankesë duhet të anulohet.

Gjykatës së Apelit, i rezultojnë të bazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se e njëjta ka tentuar të siguroj adresën e banimit për të paditurin përmes Shërbimit Civil të Komunës së Prishtinës, nga e cila ka rezultuar adresa e njëjtë e banimit e cila adresë nga gjykata ka rezultuar se i padituri është shpërngulë në Prishtinë dhe nuk jeton në fshatin Sharban/Komuna e Prishtinës,

e kjo për faktin se nga shkesat e lëndës konstatohet akti se paditëses i ishte kthyer padia për plotësim përmes aktvendimit me të cilin ishte ftuar që brenda afatit prej tre ditësh ta plotësoj me adresë të saktë të paditurit ose t'i propozoj gjykatës që të njëjtit t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm konform dispozitave të LPK-së, duke ia tërhequr vërejtën për pasojat ligjore të mos veprimit sipas tij. Megjithatë paditësja, me datë 26.05.2022, ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën në të cilën ka dhënë adresën e njëjte të të paditurit, ashtu siç është e cekur në padi duke mos propozuar gjykatës që të caktoj përfaqësues të përkohshëm për të paditurin në kuptim të nenit 79 paragrafi 3 ku parashihet se gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe *“në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë”*, dhe se referuar nenit 102 paragrafi 3 parashihet se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”*, megjithatë nisur nga kjo, i takon gjykatës së shkallës së parë që në mënyrë zyrtare të autorizoj caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e paditur I. H., mirëpo, me detyrim për palën paditëse që e njëjta brenda afatit të caktuar nga gjykata të deponoj shumën e caktuar të të hollave në emër të caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm, dhe në eventualisht pala paditëse poqëse nuk bënë deponimin e urdhëruar të të hollave nga gjykata e shkallës së parë, meqë, atëherë krijohen pengesa të pa kapërcyeshme procedurale me fajin e palës paditëse, gjykatës së shkallës së parë i krijohen kushtet ligjore që padinë e paditëses ta konsideroj të tërhequr.

Në ri vendosje, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që jashtë seancës me vlerësimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 79 par.3 i LPK-së, të autorizoj zyrtarisht caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e paditur I. H., me detyrim për palën paditëse që brenda afatit të caktuar dhe vlerësuar kohëzgjatjen e tij nga gjykata që paditësja të deponoj shumën e caktuar të të hollave për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm në arkën e gjykatës, dhe këtë aktvendim t'ia dorëzoj palës paditëse, dhe në rast të dështimit të paditëses në deponimin e kësaj shumë për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, atëherë gjykatës i krijohen kushtet ligjore që padinë e paditëses kundër të paditurit ta konsideroj të tërhequr për shkak të pengesave të pa kapërcyeshme procedurale (përfaqësimit të rregullt të palëve në gjykatë), me fajin e palës paditëse, me mos veprimin e saj sipas urdhërit të gjykatës për deponimin e të hollave në lartësinë e detyruar për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e paditur.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 5447/22, data 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka